



KUSH JEMI: A.S.V.I Onlus Shoqatë për Solidaritet dhe Vullnetarizëm Së bashku -jofitimprurëse, është shoqatë e themeluar në Itali, e regjistruar në Regjistrin Rajonal të Vullnetarizmit 8 MI – nr.7677/2001, e njohur si OJQ në Kosovë nga UNMIK-u sipas ligjit të 1999/22 n ° 5300384-2, me datë 01.08.2002 dhe e regjistruar n ° 5300384-2 në regjistrin OJQ-ve në Kosovë nr. 03/L-134 neni 9 dhe 17. Anëtarët themelues janë aktivë si vullnetarë për vite në ish-Jugosllavi dhe në Kosovë që nga viti gusht 1999, menjëherë pas përfundimit të luftës.

KU VEPROJMË: kryesisht në Kosovë, Republikë që ka shpallur pavarësinë me 17.02.2008, dhe më së shumti vepron në Mitrovicë. Mitrovica është qytet në veri të vendit, nëpër të cilin kalon lumi Ibër, që ndan atë në dy pjesë të lidhura me dy ura, në fakt, janë bërë simbol i urrejtjes dhe ndarjes mes dy grupeve të mëdha etnike. Kjo situatë vazhdon të mbahet nën kontroll nga prania e forcave ushtarake ndërkombëtare.

QËLLIMI: zbatim i projekteve për të gjithë personat dhe komunitetet e të gjitha etnive, duke u dhënë përparësi nismave në mbështetje të familjes, shkollës, shëndetësisë, punës dhe aspektit social.

MËNYRA: veprim i direkt, personal dhe falas i anëtarëve dhe një prani e vazhdueshme në realitetin në të cilin A.S.V.I. vepron duke pasur objektiva të qarta dhe të përbashkëta, menaxhim transparent të të gjitha nismave, fondeve dhe materialeve të mbledhura dhe shpërndara, përfshirja e njerëzve të ndihmuar në realizimin dhe menaxhimin e aktiviteteve të ndryshme, ndarja e rregullave dhe fryma e përkatësisë në shoqatë .

KOHËZGJATJA E PROJEKTTIT: Projekti është në zbatim që nga viti 1999 dhe vazhdohet çdo vit, pas verifikimit të vlefshmërisë dhe efikasitetit.

FINANCIMI: kontributet e mbështetësve privatë dhe partnerëve të A.S.V.I., si dhe nismat për mbledhjen e fondeve.

BASHKËPUNIMET: A.S.V.I., shoqatë jofitimprurëse bashkëpunon me shoqata tjera dhe është e hapur për persona dhe institucione që janë të gatshëm të vepron në frymën e projektit, pa dallime politike, fetare apo etnike, si në mesin e atyre që ndihmojnë dhe atyre që janë të ndihmuar.

Skeda e projekteve të A.S.V.I.-t e përditësuar në shtator 2020

Parimet thelbësore për realizimin e Projekteve janë: Dinjiteti i barabartë mes atyre që ndihmojnë dhe atyre që ndihmohen - Promovimi i paqes dhe bashkëjetesës mes popujve - Ndërgjegjësimi për të qenë pjesë e një grupi të etnive të ndryshme, por në kërkim të dialogut dhe bashkëjetesës - Dorëzimi i materialeve dhe menaxhimi i projekteve në mënyrë të drejtpërdrejt, duke siguruar menaxhim transparent të të gjitha fondeve dhe materialeve të mbledhura të

SË BASHKU NË MITROVICË: është projekti kryesor i nismave të A.S.V.I.-t. Së bashku me përkrahësit kemi për qëllim të ofrojmë ndihmë materiale, morale, psikologjike, shëndetësore dhe çfarëdo tjetër që mund të jetë e dobishme për të mbështetur më të dobët që vazhdojnë të vuajnë pasojat e luftës dhe mjerimit të shkaktuar. Dëshira është që të hartojmë, menaxhojmë dhe realizojmë projektet gjithmonë në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke siguruar përfundimin e suksesshëm të çdo nisme, duke aplikuar parimet e solidaritetit e ndërsjellë mes të gjitha etnive të Kosovës, pra duke mbështetur, shqiptarët, serbët, romët, boshnjakët, goranët. Intervenimet tona do të përqendrohen në familje, shëndetësi, punë, shkollë dhe shoqëri. Në kuadër të këtij kuadri janë ndërmarë projekte të veçanta që do të ilustrojmë shkurtimisht më poshtë.

FAMILJA: Nga viti 2000-2010 është realizuar *Projekti i Adoptimit*. Përmes adoptimit nga familjet italiane, 100 familje kosovare me vështirësi serioze janë ndihmuar deri në rifillimin e një ekzistence dinjitoze. Nga viti 2011, falë përvojës dhe pjekurisë së fituar, vazhdon *Projekti Mbështetje ndaj familjeve* me synim ofrimin e ndihmës ndaj një numri më të madh të familjeve kosovare të tashmë në një varfëri kronike. Projekti është realizuar në bashkëpunim me 8 Shoqata vendore dhe aktualisht mbështet 1600 familje me rreth 800 persona. Duke filluar nga viti 2020, u vendos një mënyrë tjetër për zbatimin e projekteve, duke hequr dorë nga mbledhja e materialeve në Itali dhe dërgimi i tyre në Kosovë. Ndiham ushqimore do të vazhdojë të shpërndahet si në të kaluarën, duke blerë prodhimet dhe duke përgatitur pakot e ndihmës direkt në Kosovë dhe duke përfshirë në këtë aktivitet direkt OJQ-të vendore të etnisë shqiptare dhe serbe. Falë kursimeve të shpenzimeve të bëra deri më tani në Itali për organizimin logjistik, bazuar në nevojat reale dhe të verifikuara, ndihmat tjera do të blihen në vend, duke rritur edhe mbështetjen ekonomike për projekte specifike në mënyrë që ndihma të mos bëhet kronike, por të jetë një mundësi për një pavarësi ekonomike për familjet, falë pikërisht projekteve që synojnë mundësi punësimi dhe mikrokrede. Roli i ASVI-t mbetet ai i planifikimit dhe menaxhimit të të gjithë aktivitetit, gjetja e materialeve dhe fondeve të nevojshme; detyra e OJQ-ve vendore është zgjedhja dhe kujdesi për familjet, shpërndarja e ndihmave. Gjatë secilit mision, dhe në të njëjtën kohë edhe përmes video-thirrjeve dhe mjeteve të ngjashme, Projekti verifikohet dhe kontrollohet, si me takime me drejtuesit e OJQ-ve vendore, ashtu edhe me vizita në familjet e ndihmuara.

SHËNDETËSIA: Projektet shëndetësore: Shpërndarja e barnave esenciale të sëmurëve kronik në nevojë dhe intervenime tjera vendimtare për cilësinë e jetës e shpesh për mbijetesë, prej të cilave kanë përfituar qindra njerëz. *Projektet shëndetësore për fëmijë:* ka filluar në vitin 2009 pas kërkesave të shumta për ndërhyrje shëndetësore për fëmijë, projekti parashih dy ekzaminime shëndetësore në vit në Kosovë, të realizuara falë intervenimeve të pjekëve specialistë në Ambulanten tonë në Mitrovicë dhe shtrimit eventual në Itali të pacientëve të vegjël me patologji që nuk trajtohen në vend. Edhe pse ndonjëherë kemi të bëjmë me raste të rënda dhe të pazgjydhshme edhe në Itali, në shumë raste tjera intervenimi i A.S.V.I-t ka mundësuar shpëtimin e jetëve njerëzore të këtyre fëmijëve. Deri më sot, ne kemi arritur të sjellim në Itali 132 fëmijë që ju kanë nënshtuar operacioneve të rënda kardiokirurgjike ose për të marrë një diagnozë të saktë të patologjive të tyre. Kemi realizuar dhe përfunduar *Projekte dentare* duke ofruar në veçanti trajtimin falas në klinikat dentare të Kotlina dhe Mitrovica, të ngritura nga ASVI dhe të menaxhuara drejtpërdrejt nga dentistët tanë vullnetarë. Në vitin 2010, ne e realizuam qëllimin e projektit duke dhuruar Ambulanten e Mitrovicës Administratës shëndetësore të qytetit, e cila mori përsipër përgjegjësinë e menaxhimit të drejtpërdrejt.

PUNA: Projekt i mikro-aktivitetit: duke e konsideruar punën si një përparësi për rifillimin e një jete dinjitoze, vazhdimisht nxisim aktivitete pune, duke favorizuar ato që janë të lehta dhe të menjëhershme për t'u zbatuar, përmes projekteve të konkrete dhe promovimit të mikrokredivë. Deri më sot ne kemi promovuar aktivitete të ndryshme artizanale dhe bujqësore. Të ardhurat u lejojnë familjeve të bëhen ekonomikisht të pavarura.

SHKOLLA: duke pasur parasysh që shkolla është themeli i arsimimit të individit, ne kemi aktivizuar disa projekte. *Projekti për Mbështetjen e Shkollës:* mbështesim institucione të ndryshme dhe studentë individualë me pajisje dhe materiale arsimore, informatike dhe kontribute për blerjen e librave shkollorë. *Projekti universitar:* dhënia e bursave të studimit. Që nga fillimi i projektit në vitin shkollor 07/08, ne kemi dhënë 31 bursa të studimit me 500,00 € secila të barabarta me 50% të koston vjetore për student, duke garantuar financim për të gjithë vitin, por me klauzola dhe rregulla të sakta për t'u respektuar. Deri më sot, 14 studentë janë diplomuar tashmë. Në vitin 2011 u përbyll *Projekti i Binjakëzimit të Shkollave* mes shkollave italiane dhe shkollave kosovare.

SOCIALE: pasi kemi verifikuar me kujdes parimet dhe metodat e ndërhyrjes, kemi intensifikuar mbështetjen dhe bashkëpunimin me shoqata të ndryshme vendore, të të dy etnive shqiptare dhe serbe, të cilat vepron në fushën e aftësive të kufizuara dhe vështirësive sociale dhe ekonomike: Q.M.F.G, Iniciativa Fisniku, Asvi Nord, Asvi Sud, Shoqata Sindrom Doëni, Shoqata Opfakkos, Shoqata Podrzy Me. Ndiham jonë ka të bëjë me dhënie e ndihmave të ndryshme për familjet që ata mbështesin, kontribute financiare për projekte specifike dhe për menaxhimin e shoqatës dhe aktiviteteve e saj sociale. *Projekti për mbështetjen e familjes* realizohet me disa nga këto shoqata. Ndër projektet e përfunduara janë ndërtimi i një ndërtese shkollore për fëmijë jetimë në fshatin Kotlina, rinovimi i shkollës Handikos për fëmijë me nevoja të veçanta, mbështetja për 25 familje refugjatësh që jetonin në një ndërtesë të rrënuar dhe tani janë vendosur në dhe shtëpi të mira, binjakëzimi me sektorin e rinisë në disa klube sportive. *Projekti Ndihamojmë kë Ndihamon:* duke mos mundur të promovojmë drejtpërdrejt projekte në shumë pjesë të botës me situata të shqetësimit të madh socio-kulturor, falë ndarjes së një miksi dhe mbështetjes, ASVI ka vendosur të mbështesë shoqatat e tjera që kanë aktivizuar projekte që synojnë trajnimin dhe sferën arsimore të moshave shkollore. Pas një vlerësimi të kujdesshëm të shoqatave dhe projekteve të tyre, janë identifikuar dhe mbështetur projekte në Tanzani me shoqatën "Il battito che unisce" e Ankonës dhe një në Togo me "Il pozzo della farfalla" nga Potenza.

NË ITALI: ASVI, e vetëdijshëm për vuajtjet e përhapura edhe në Itali, gjithmonë mbështet personat dhe komunitetet vendore duke shpërndarë ushqime e materiale dhe duke bashkëpunuar me shoqata të tjera. Angazhimi u bë më i qëndrueshëm në vitin 2020 pas krizës ekonomike për shkak të emergjencës Covid 19 me ndërhyrje të shumta në ndihmë ndaj familjeve dhe personave në vështirësi të mëdha ekonomike.

Secili projekt përmban një skedë të detajuar në të cilën shprehen qëllimet, mënyra e funksionimit, financimi dhe përfituesit.